

UNMIK/REG/2004/40  
14 tetor 2004

---

**RREGULLORE NR. 2004/40**

**PËR SHPALLJEN  
E LIGJIT MBI NDRYSHIMIN E LIGJIT NR. 2003/3  
MBI PYJET E KOSOVËS  
TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në përputhje me kapitullin 8 dhe paragrafët 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh komunikatën e kryetarit të Kuvendit të Kosovës të datës 6 gusht 2004 lidhur me Ligjin për ndryshimin e Ligjit nr. 2003/3 mbi pyjet e Kosovës të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 28 korrik 2004,

A. Nëpërmjet kësaj shpall Ligjin për ndryshimin e Ligjit nr. 2003/3 mbi pyjet e Kosovës (Ligji nr. 2004/29) në varësi të nenit B më poshtë i cili i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje dhe bëhet i plotfuqishëm në ditën e nënshkrimit dhe

B. Vendos që:

(a) Në nenin i fjalët “Gjykata e gjobit me gjobë personin për kundërvajtje” fshihet dhe zëvendësohet si vijon: “Përveç kompensimit tjetër i cili mund të jetë caktuar me ligj, gjykata mund ta gjobisë personin për kundërvajtje në pajtim me ligjin në fuqi”;

(b) Neni 3 ndryshohet si vijon: “Neni 36.6 është si vijon: “Përveç kompensimit tjetër i cili mund të jetë caktuar me ligj, gjykata mund ta gjobisë prindin për kundërvajtje në pajtim me ligjin në fuqi”;

(c) Dispozita vijuese përfshihet si nen i ri me numër 5:

“Titulli i kapitullit XI “Dënimet” në Ligjin nr. 2003/3 zëvendësohet me “Sanksione administrative” dhe neni vijues rinumërohet në pajtim me këtë.

E nënshkruar më 14 tetor 2004.

Søren Jessen-Petersen  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm